



Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike

Nr. 1502 Prot.

Tiranë, më 15/02/2024

**DREJTUAR: Z. PETRIT AHMETI
KRYETAR I BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE**

Lënda: Komentet e Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë Elektrike rreth Draft Metodologjisë mbi Përcaktimin e Detyrimit për Energjinë e Rinovueshme për t'u Paguar nga Konsumatorët Fundorë të Energjisë Elektrike.

I nderuar Z. Ahmeti,

Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (në vijim AAES) është vënë në dijeni të Draft Metodologjisë mbi Përcaktimin e Detyrimit për Energjinë e Rinovueshme për t'u Paguar nga Konsumatorët Fundorë të Energjisë Elektrike (në vijim "Medotologjia") përmes publikimit të saj për konsultim në website-in e ERE. Në vlerësimin e AAES, Metodologjia, edhe pse përfaqëson një hap para në zhvillimin e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike ka nevojë për përmirësim të ndjeshëm.

Lutem gjeni në vijim pozicionin/komentet dhe AAES.

- 1) Neni 5, par. 1, kërkon qe "Brenda datës 1 Shtator të çdo viti, të gjithë furnizuesit e energjisë elektrike do t'i paraqesin OER një parashikim vjetor të vëllimit të energjisë elektrike që pritet të furnizohet prej tyre të ndarë sipas muajve për vitin pasardhës". dhe
- 2) Nenit 6, par. 1, kërkon nga të gjithë prodhuesit me përparësi në operim si dhe prodhuesit me përparësi të cilët planifikojnë të vënë në funksion impiantet e tyre në vitin pasardhës ti paraqesin "Operatorit te Energjisë së Rinovueshme" (në vijim "OER") parashikim vjetor të vëllimit të energjisë elektrike që pritet të gjenerohet.

AAES vlerëson se kërkosat më lart janë jo realiste dhe të pa aplikueshme në kushtet aktuale të operimit të tregut. Kjo pasi në eksperiençen/historikun e të gjithë anetarëve të AAES (dhe jo vetëm) asnjë kontatë furnizimi nuk është lidhur me Konsumatorët deri në datën 1 Shtator të vitit që i paraprin vitit për të cilët kërkohet parashikimi (4 muaj në avance). I njëjtë arsyetim është i vlefshem edhe per prodhuesit me përparësi të cilët janë të ekspozuar 100% karshi kushtve meteorologjike dhe e kanë të pamundur parashikimin e gjenerimit te tyre, duke Ju mbetur, ashtu si edhe Furnizuesve, vetëm mundësia e një parashikimi arbitrar/subjektiv. Dhënia e parashikimeve përfurnizim/gjenerim potencial do të nxiste Furnizuesit të jepnin parashikime në ulje ndërsa prodhesit në rritje dhe si pasoje devijimi, mes furnizimit të parashikuar dhe atij faktit apo gjenerimit të parashikuar dhe atij faktit, do të ishte i lartë duke u përkthyer në llogaritjen e një Detyrimi për Energjinë e Rinovueshme (në vijim Detyrimi RES) larg realitetit.

Për shmagnien e problematikës më lart, propozojmë që, për të ndertuar parashikimet e sipër-përmendura të merren si vlera reference të furnizimit dhe të Gjenerimit nga

Burime të rrinovueshme (në vijim Gjenerimi RES) ato të vitit të fundit (p.sh. vlerat e vitit 2022 për vitin 2024). Për reflektuar rritjen e mundshme të konsumit apo Gjenerimit RES vlerat e zgjedhura të indeksohen me rritjen mesatare të secilës gjatë 3 viteve të fundit.

Kjo mënyrë llogaritje do të ofronte ndërtimin e parashikimeve me bazë reale dhe do të shmanget aplikimin e probabiliteteve tejet të ulta (P 10) për Gjenerimin RES (të pritshëm përmendur në vijim të metodologjisë (pavaresisht justifikimit për të reduktuar riskun e mungesës së financimit i cili nuk egziston).

Gjithashtu, përmes kësaj llogaritjeje, ofrohet një bazë solide për përcaktimin e Tarifes Unitare për Energjinë e Rrinovueshme (Tarifa RES) për të cilën Konsumatorët duhet të kenë qartësinë dhe transparencën maksimale.

- 3)** Neni 4, par. 11, Neni 5, par. 5, 6 dhe 8, Neni 8, par. 3, parashikojne mundësine që ERE vendose per aplikimin e parapagesave mujore, tremujore apo vjetore nga Furnizuesve. Kjo nëse vlerëson se OER ka pamundësi fondesh.

AAES vlerëson këto parashikime si totalisht të padrejta dhe abuzive. Shqipëria do të ishte i pari vend në Europë (në mos në Botë) i cili do të detyronte furnizuesit e energjisë ti nënshtroheshim parapagesave të një niveli të tillë, të llogaritura vetëm mbi parashikime/supozime subjektive.

Në vlerësimin e AAES, mundësia që OER të këtë pamundësi fondesh është pothuajse në limitet e të pamundurës. Bazuar në operimin e industrisë, OER do të tregtojë Energjine RES çdo ditë në Bursën Shqipare të Energjisë (ALPEX) si dhe do të paguhet nga kjo e fundit (për energjinë e treguar) sërisht po me nga me baza ditore. Nga ana tjetër, vet OER do të shlyejë detyrimet e tij ndaj Gjeneruesve RES me baza mujore (të paktën pas datës 20 te muajit pasardhës). Po në të njëjtën optike, Furnizuesit, sipas parashikimeve të Metodologjisë, duhet të shlyejnë detyrimet e tyre 5 ditë pas lëshmit të faturës nga OER. Edhe në këtë rast, përpara datës në të cilën OER shlyen detyrimet e tij (ndaj Gjeneratoreve RES apo të tjera administrative).

Jo vetëm! Llogjika e parapagesave do të shërbejë si një barriere e hyrëse (kosto) në treg përfurnizuesit e rinj të detyruar të parapaguajnë për diçka thjesht hipotetike pasi, nëse mbi ta nuk do të aplikohet e njëtja llogjikë, atëherë do të diskriminoheshin furnizuesit aktivë në treg duke i vendosur në pozita jo të barabarta.

Duke arsyetuar si më lart kërkojmë mosmarrjen në konsideratë të mundësisë për të operuar nëpërmjet parapagesave si një praktikë totalisht e dëmshme përfunizuesit, e cila bie ndesh me praktikat e industrise ne Bashkimin European, dhe jo vetëm, por edhe totalisht e pa justifikuar përfasin e OER.

- 4)** Neni 4, par. 10, parashikon: “OER-ja ka të drejtën të rikuperojë çdo pagesë të paarkëtuar nga një furnizues i falimentuar, duke i ndarë këto të arkëtueshme të pambledhura me furnizuesit e mbetur në treg, në proporcione pjesën e tregut që zë secili furnizues”

Ky parashikim është jo koherent dhe në kundërshtim me çdo praktikë tregtare. Asnjë shoqëri, në tregun e energjisë dhe jo vetëm, nuk mund të jetë përgjegjëse përfkëqveprimet, neglizhencën apo abuzimet e një shoqërie tjetër konkurrente.

Aq më tepër në rastin tonë ku një subjekt si FSHU ka mbi 90% të tregut të furnizimit. Mospërbushja e detyrimeve nga FSHU do të thotë një barrë kolosale, totalisht e pa justifikuar, që bie mbi të gjithë furnizuesit e tjera dhe e shkaktuar nga veprime të cilat nuk varen nga këta të fundit.

Bazuar në sa më lart, kërkojmë mosmarrjen në konsideratë të parashikimit të Nenit 4, par. 10.

AAES propozon kushtëzimin e pjesëmarrjes në treg për të gjithë furnizuesit, përmes lëshimit të një kolaterali finaciar (garanci bankare) në favor të OER. Në rast të mos vënies në dispozicion të kolateralit furnizuesi të mos lejohet që të marrë pjesë në tregun e furnizimit. Vlera e kolateralit finaciar të jetë dyfishi i detyrimit mujor i Furnizuesi me qëllim për të evitar ekspozim të OER dhe të këtë afat 1 vjeçar. Bazuar në propozimin e AAES per pikat 1) dhe 2) më lart, detyrimi mujor i secilit Furnizues të llogaritet bazuar në furnizimin e tij (market share) gjatë vitit që shërben si bazë për llogaritjen e parashikimeve. Për funizuesit e rinj (pa kontrata të mëparshme) të llogaritet bazuar në sasitë e deklaruara në konsumin historik mujor të Konsumatorit me të cilin do të njoftojë kontratën. Gjithashtu, propozjmë të lihet e hapur mundësia që, në rast të rritjes/uljes së ndjeshme kuotës së tregut të Furnizuesit, ky i fundit të ketë mundësinë të përditësojë (rrisë/reduktione) vlerën e kolateralit (psh. me bazë 3 mujore).

Në këtë menyre, eksposzimi i OER apo mundësia që të cënohen flukset e tij financiare (cash flow) nga mos-performance e furnizuesve do të jetë zero absolute.

5) Neni 8, par. 5 parashikon: "Në rast të diferencave ndërmjet parashikimeve dhe realizimeve të tregut, OER do të kryejë një rakordim [pas çdo muaji ose çdo tre-mjori të përcaktuar me vendimin e ERE-s dhe do të rregullojë grupin e ardhshëm të pagesave në përputhje me rrëthanat]. OER do të informojë ERE-n për rakordinin e të dhënavë sa më shpejt të jetë e mundur"

Ky parashikim, jo vetëm nuk ndihmon, por vendos Furnizuesit dhe Konsumatorët përballë veprimeve rregulluese duke hequr "qartësinë" e furnizimit me çmim fiks. Sipas parashikimit në fjalë, veprime financiare për rregullime shtohen mes OER dhe Furnizuesve. Këta të fundit do të transferojnë këto "rregullime" (efektet financiare) tek Konsumatorët duke lënë hapësirë për lindjen e jo pak kontesimeve/konflikteve, veçanërisht nga konsumatorët që kanë lidhur kontrata furnizimi afatgjata me çmim fiks.

AAES, propozon që Tarifa RES e faturuar konsumatoreve (unitare për kWh të furnizuar) të jetë e fikse dhe e pa ndryshueshmer për një afat minimal 1 vjeçar duke ndjekur të njëjtën metodë të suksesshme që ndiqet në miratimin e tarifave të rrjetit nga OST apo OSSH. Tarifat të cilat do të miratohen për vitin pasardhës do të reflektojnë edhe devijimin gjatë vitit aktual.

Lutemi marrjen në konsideratë të kërkeseve tona.
Ju falenderojmë paraprakisht për bashkëpunimin.

Me respekt,



KRYETARI
OLSI TURABI